

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më /12/2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data 23.12.2020]

Për: **OE: “Kronos Konstruksion” Shpk** me adresë: Bulevardi Gjergj Fishta, Pranë ish ekspozitës Shqipëria Sot , Tiranë me NIPT: K41416033P, i përfaqësuar nga Administratori i saj Z. Vasil Jovani.

Procedura e prokurimit: Procedurë e HAPUR – PUNË

Numri i referencës së procedurës: REF-71910-09-15-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksioni i rrjetit kabllor 35 kV i furnizimit N/Stacionit të Pallatit të Kongreseve”**, me fondin total 139. 920. 799 (njëqind e tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e njëzet mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga të ardhurat e OSHEE sh.a”, zëri i investimeve 2020 dhe **me afat realizimi 5 (pesë) muaj, nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit nga mbikqyrësi i punimeve.**

Publikime të mëparshme (*Nuk ka*)

Buletini i Njoftimeve Publike *Data* 16.09.2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë Operatorët Ekonomik me vlera përkatëse të ofruar:

**Emërtimi i Shoqërive pjesmarrëse:**

NR	Emërtimi i Shoqërisë	Oferta në lekë paTVSH
1	OE: “EN – EL” me Nr. Nipti L22405011A	PA OFERTE

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

2	OE: “Kronos Konstruksion” shpk me Nr. Nipti K41416033P	137,003,138.8
3	BOE: “Rafin Company” shpk me Nr. Nipti L52125110A & “Bajrami N” me Nr. Nipti K02727202O.	133,233,344.9
4	BOE: “Sterkaj” shpk me Nr. Nipti J68310708M & “Aci Engineering” shpk me Nr. Nipti L51609014F.	124,404,662

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1. OE: Operatori ekonomik: “En - El” shpk** Vlera totale e ofertes pa tvsh = 0 lekë dhe Vlera totale e ofertës me tvsh = 0 lekë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga kjo shoqëri, nga ku rezultoi si më poshtë:

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “En El” shpk konstatohet se në sistemin elektronik nuk ka paraqitur ofertën ekonomike si dhe asnjë dokument ligjor dhe teknik, për këtë KVO e konsideron të pamundur vlerësimin dhe klasifikimin e kësaj oferte. Komisioni i Vlerësimit vendosi të s’kualifikojë për arsyet e sipërcituara shoqërinë si më poshtë vijon: “EN EL” shpk.

**Sa me sipër komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “En El” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion në përputhje me kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit dhe vendos ta shpallë të pavlefshme këtë ofertë.**

- 2. BOE: “Sterkaj” shpk me Nr. Nipti J68310708M & “Aci Engineering” shpk me Nr. Nipti L51609014F.**

Vlera totale e ofertes pa tvsh = 124,404,662 lekë dhe Vlera totale e ofertës me tvsh = 149,285,594 lekë. Afati i realizimit të kontratës është **5 (pesë) muaj kalendarike, nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit nga mbikqyrësi i punimeve.**

**Komisioni procedoi me tej me shqyrtimin e dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik si me poshte:**

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

➤ Në pikën 1.d. të Kriteve Të përgjithshme Për Kualifikim, AK ka kërkuar që *Ofertuesi duhet të deklarojë se: ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

OE: “Sterkaj” Shpk ka deklaruar shlyerjen e ketyre detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi, ndërkohe, nuk ka permbushur detyrimin e ketij legjislacioni sa I takon detyrimeve të stafit teknik si vijon:

- Z. Tereze Kiri, mjeke, referuar kontrates së punës paga e saj është 35.000 leke, ndërkohe, në listpagesa figuron me pagë 30.000 leke.

- Punonjësit Kamber Nazeri dhe Kadri Lena, dhe manovratorin Gerti Hoshja, referuar kontrates së punës paga e tyre është 35.000 leke, ndërkohe, në listpagesa figurojnë me pagë 30.000 leke.

Sa me sipër, OE “Sterkaj” Shpk ka vepruar në kundërshtim me pikën 2/d të nenit 45 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka permbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës”.

➤ **Ne pikën 1.gj të kriteve të vecanta është kërkuar:** ”Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: *e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Për të permbushur këtë kriter OE: “Sterkaj” Shpk ka paraqitur vërtetimin e debise OSHEE-2020-5800757-ZH, datë 12.10.2020, ku thuhet se për kontratat me kod **TR1B110031112509** titullar i të ciles është Sterkaj Shpk, rezultojnë të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 12.10.2020, pa përfshirë faturën koherente të muajit Shtator 2020.

Referuar ekstraktit të QKB OE “Sterkaj” Shpk ka 6 adresa të ushtrimit të aktivitetit dhe duhet të kishte paraqitur informacion mbi kontratat e energjise në të gjitha këto adresa. Gjithashtu, shoqëria **ACI ENGINEERING** ka paraqitur informacion vetëm për kontratën (me kod) TR1B030396174608, ka 2 adresa të ushtrimit të aktivitetit dhe duhet të kishte paraqitur informacion mbi kontratat e energjise në të gjitha këto adresa.

➤ Në pikën 2.1.2.a të kriteve të vecanta është kërkuar: ”Për kapacitetin ekonomik dhe financiar: *Kopje të vërtetuara të bilanceve, të konfirmuara me vullnet autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të fundit të aktivitetit (2017, 2018, 2019). Të gjitha subjektet që i nënshtrohen përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar”.*

## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Bilanci i vitit 2017 i OE: "Sterkaj" Shpk nuk shoqerohet me raportin e audituesit te pavarur, ne kundërshtim me përcaktimet e nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, nderkohe ka gene subjekt I ketij neni ne vitin 2017.

- Ne piken 2.1.2.d te kriterëve te vecanta eshte kerkuar: "Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) I ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, per vitin 2019 dhe 2020, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë kete dokument)".

OE: "Sterkaj" Shpk nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyrjen e detyrimeve te taksave vendore per vitin 2019 ne Corovode dhe per vitin 2020 ne Corovode, Lushnje, Berat, Korce dhe Kruje, nderkohe ka ushtruar aktivitetet ne keto bashki, referuar ekstraktit historik te QKB.

- Ne piken 2.3.a te kriterëve te vecanta eshte kerkuar: "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a.1) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.  
a. 2) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jomë e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipër përmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon:*

- *Formulari i vleresimit sipas shtojces 8, si vërtetime të lëshuara nga një ent publik .*
- *Kontraten.*
- *Situacionet pjesore dhe perfundimtare*
- *Faturat tatimore perkatese per cdo situacion*
- *Akt kolaudimi*
- *Certifikata e marrjes ne dorezim te leshuar nga autoriteti kontraktor.*

*Në rastin e përvojës së më parshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon:*

- *Kontrate.*
- *Situacionet pjesore/perfundimtare*
- *Faturat tatimore perkatese*
- *Akt kolaudimi*

## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE

*Kontrata te ngjashme konsiderohen te vlefshme nese zerat kryesore te punimeve te kene Volume te konsiderueshme krahasimore te percaktuara ne kete prokurim”.*

OE: “Sterkaj” Shpk ka paraqitur dokumentacion per kontraten Nr. 16977/7, date 23.10.2018 me objekt: “Ndertim linje transmetimi ujesjellesi nga rruga “Dine Hoxha” deri ne rrugen: “Azem Galica”, por nuk ka paraqitur **Certifikata e marrjes ne dorezim te leshuar nga autoriteti kontraktor**. Gjithshtu, fatura per situacionin perfundimar nuk eshte nenshkruar nga asnje person, duke mos pasur keshtu elementet minimale ligjore te parashikuar ne legjislacionin e fushes perkatese.

➤ Ne piken 2.3.3 te kriterëve te vecanta eshte kerkuar: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet dhe makinerit (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;*

5	Trencher per hapje kanali (min.20 ton)	1 cope
6	Trencher per punime speciale nentokesore	1 cope
9	Betoniere kantieri 500 lit.	2 cope
16	Asfaltoshtruse	1 cope

Asnje nga OE: “Sterkaj” Shpk dhe “Aci Engineering” Shpk nuk i disponon mjetet e sipercituara.

Gjithashtu, eshte kerkuar edhe:

17	Impiant asfalti	1 cope
----	-----------------	--------

Për impiantin e asfaltit duhet te paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL. Nese eshte marre me qira/furnizim krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase/furnizimit. Operatori ekonomik per fabriken e asfaltit mund te paraqese edhe kontrata te vlefshme furnizimi me operatore ekonomike. Ne kete rast duhet te paraqese kontraten e furnizimit dhe **dokumentacionin qe verteton ekzistencen dhe pronesine e impiantit.**

Shoqeria: “Sterkaj” Shpk ka paraqitur kontrate qirale per kete maknieri, por kontratat e qirase nuk shoqerohet me **dokumentacionin qe verteton ekzistencen dhe pronesine e impiantit nga ana e qiradhenesit.**

Në nenin 53/3 të të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

### **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Në nenin 66, pika 3, të VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se: *“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.*

Sa më sipër, BOE “Sterkaj” Shpk & “Aci Engineering” Shpk skualifikohet për mospërmbushje të kriterëve të kualifikimit.

### **3. Komisioni procedoi me tej me shqyrtimin e dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik si më poshtë: BOE: “Rafin” SHPK & “Bajrami N” SHPK:**

➤ Në pikën 1.d. të Kriterëve Të përgjithshme Për Kualifikim, AK ka kërkuar që *Ofertuesi duhet të deklarojë se:ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

OE: “Bajrami N” Shpk ka deklaruar shlyerjen e ketyre detyrimeve sipas legjislacionit ne fuqi, ndërkohe, nuk ka përmbushur detyrimin e ketij legjislacioni sa I takon detyrimeve të punonjesit Euklid Lleshaj, paga e të cilit sipas kontrates se punes eshte 35.000 leke dhe ne listapagesat Janar e Shkurt 2020 figuron me 0 (zero) leke dhe ne Mars 2020 me 19.291 leke.

Sa me siper, OE: “Bajrami N” Shpk ka vepruar ne kundërshtim me pikën 2/d të nenit 45 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës”.**

➤ Ne piken 1.gj te kriterëve te vecanta eshte kerkuar: *”Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Per te përmbushur kete kriter OE “Bajrami N” Shpk ka paraqitur vertetimin e debise nr. 634/1 Prot., date 30.09.2020, ku thuhet se për kontraten me kod ELOB020233063397, titullar i se ciles eshte Bajrami N Shpk, rezulton te kete ne total 0 leke detyrimeper faturat e energjise elektrike, vlere e llogaritur deri ne daten 30.09.2020, duke perfshire fature koherente te muajit Gusht 2020.

Referuar ekstraktit te QKB OE “Bajrami” Shpk ka 1 adresa te ushtrimit te aktivitetit dhe duhet te kishte paraqitur informacion mbi kontratat e energjise ne te gjitha kete adrese. Nderkohe, referuar deklarates mbi kontrates se proces, kjo shoqeri ka edhe 10 objekte te tjere, per minimalisht 6 nga te cilet (jane objekte sociale) duhet te kishte paraqitur informacion mbi shlyerjen e detyrimeve.

## DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Gjithashtu, shoqëria “Rafin” Shpk ka paraqitur informacion vetem per nje kontrate energjie ne Tirane referuar deklarates mbi kontrates se proces, kjo shoqëri ka edhe 5 objekte te tjere, dhe duhet te kishte paraqitur informacion mbi kontratat e energjise ne te gjitha keto adresa.

- Ne piken 2.1.2.d te kritereve te vecanta eshte kerkuar: *”Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) I ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, per vitin 2019 dhe 2020, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë kete dokument)”*.

OE “Rafin” Shpk nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyrjen e detyrimeve te taksave vendore per vitin 2020 ne Belsh, Berat dhe Durres, nderkohe referuar deklarates mbi kontrates se proces, ka deklaruar se ka objekte ne keto bashki.

Gjithashtu, OE “Bajrami” Shpk nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyrjen e detyrimeve te taksave vendore per vitin 2020 ne Berat, Durres, Librazhd, Korce dhe Rrogozhine, nderkohe referuar deklarates mbi kontrates se proces, ka deklaruar se ka objekte ne keto bashki.

- Ne piken 2.3.c te kritereve te vecanta eshte kerkuar: *Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:*
- *EN-ISO 9001 ( Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent.*
  - *EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent.*
  - *ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ose Ekuivalent.*
  - *ISO 50001 (Sistemin per menaxhimin e energjise) ose ekuivalent.*
- Lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim”*.

Certifikata e paraqitura nga OE “Bajrami N” Shpk jane per *“Ndërtime dhe rikonstruksione të infrastrukturës rrugore, ndërtesave civile dhe industriale,ujësjellësa, kanalizime, vepra lumore dhe sistemime hidraulike.*

*Prodhim dhe shitje të betonit, materialeve inerte dhe elementeve parafabrikate të veçantë prej betoni. Zbatimetë punimeve për sistemime të hapësirave të gjelbërta dhe mbjellje bimësh e pemësh”* dhe nuk kane lidhje me punimet elektrike qe ka marre persiper te realizoje ne kete procedure prokurimi.

- Ne piken 2.3.3 te kritereve te vecanta pervec te tjerave eshte kerkuar: *” Operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet dhe makinerit (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;*

Nr.	Pershkrimi i Automjetit	Sasia
5	Trencher per hapje kanali (min.20 ton)	1 cope

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHETËSE**

6	Trencher per punime speciale nentokesore	1 cope
10	Pajisje portabel per matjen e shkarkimeve siperfaqsores	1 cope
13	Megaohmmeter	1 cope
17	Impiant asfalti	1 cope

1. Asnje nga shoqerite “Rafin” Shpk dhe “Bajrami N” Shpk nuk ka paraqitur dokumentacionin lidhur me disponimin e mjetit “Trencher per hapje kanali (min.20 ton)”
  2. OE: “Bajrami N” Shpk nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me disponimin e mjetit “Trencher per punime speciale nentokesore”. Nderkohe, per kete mjet OE “Rafin” Shpk ka paraqitur nje kontrate qeraje (Nr. 2828 rep. nr, 931 kol, date 21.10.2020) por kjo kontrate nuk shoqerohet me dokument qe provon se qiradhenesi “Premium Albania” shpk e disponon kete mjet. Bashkelidhur eshte nje shkrese “kthim pergjigje” Nr. 15233/2, date 11.01.2019, nga Dega e Doganes Tirane, e cila, se pari nuk eshte dokument pronesie dhe se dyti ka te beje me nje mjet “ngarkues me lopata” dhe jo me trencherin e kerkuar ne kete kriter.
  3. Referuar marreveshjes se bashkepunimit ndermjet operatoreve ekonomik Nr. 2628 Rep., Nr 929 Kol., date 21.10.2020. OE: “Rafin” Shpk ka marre persiper edhe realizimin e punimeve elektrike, per te cilat nevojitet “Pajisje portabel per matjen e shkarkimeve siperfaqsores” dhe “Megaohmmeter”, por kjo shoqeri nuk disponon asnje prej ketyre pajisjeve.
  4. Referuar marreveshjes se bashkepunimit ndermjet operatoreve ekonomik Nr. 2628 Rep., Nr 929 Kol., date 21.10.2020. OE: “Rafin” Shpk ka marre persiper edhe **realizimin e te gjitha punimeve te asfaltobetonit**, por kjo shoqeri nuk ka paraqitur dokumentacion per te provuar se disponon Impiant asfalti.
- Ne piken 2.3.4 te kriterave te vecanta pervec te tjerave eshte kerkuar: ”Per Listen e meposhteme te artikujve (Pajisjet 35 kV/ kablli sipas specifikimeve):

- Ceta transformatori
- Kabell 35 KV XLPE
- Koka Kablli
- Mufte

**Operatori ekonomik duhet te paraqese:**

- 1 Autorizim te prodhuesit/ve/ distributoreve per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.



## **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

- 2 *Katalogun/et e prodhuesit/ve ne gjuhen angleze per listen e mesiperme, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen. Shenim (Në rastet kur vlerësohen pamundësi të përkthimit të plotë të katalogut nga OE, AK mund të pranojë që OE të paraqesin të perkthyer në gjuhen shqipe vetëm pjesë të rendesishme teknike të katalogut, ku janë përcaktuar të dhënat teknike/specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi).*
- 3 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimave zyrtare te kryera, te leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara (lista mesiper e materialeve) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.*
- 4 *Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese tabelat me te dhenat teknike perkatese te materialeve te ofruara”.*

Referuar marreveshjes se bashkepunimit ndermjet operatoreve ekonomik Nr. 2628 Rep., Nr 929 Kol., date 21.10.2020. OE “Bajrami N” Shpk ka marre persiper edhe realizimin e punimeve ne lidhje me artikujt apo materialet:

- *Kabell 35 KV XLPE*
- *Koka Kablli*
- *Mufte,*

por kjo shoqeri nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi dhe dokumentacion shoqerues, per asnje nga keto materiale.

Në nenin 53/3 të të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

Në nenin 66, pika 3, të VKM Nr. 914 ,datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Sa më sipër, BOE: “Rafin” Shpk & “Bajrami N” Shpk skualifikohet për mospërmbushje të kriterëve te kualifikimit.

### **5. OE: “Kronos Konstruktion” shpk me Nr. Nipti K41416033P.**

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Vlera totale e ofertës pa tvsh = 137,003,138.8 lekë dhe Vlera totale e ofertës me tvsh = 164,403,766.6 lekë. Afati i realizimit të kontratës është **5 (pesë) muaj kalendarike, nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit nga mbikqyrësi i punimeve.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të pikes 4 të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, konkludon se oferta në tërësi përmbush kriteret për kualifikim të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit.

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 56 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr 914 dt 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu VII neni 66 pika 5 u be përlllogaritjen e ofertës anomalisht të ulët. Nga përlllogaritja rezultoi se oferta e operatorit ekonomik të kualifikuar nuk vlerësohet si oferte anomalisht e ulët pra është ofertë e rregullt.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas kualifikimit të shoqërisë verifikoi ofertën e saj për gabime aritmetike në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu VII Neni 66, pika 4 dhe konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Sa më sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor dhe teknik si dhe verifikimit të ofertës për gabime aritmetike Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e operatorit ekonomik: **“Kronos Konstruktion” shpk me Nr. Nipti K41416033P** është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të vlefshme.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **OE: “Kronos Konstruktion” shpk me Nr. Nipti K41416033P** se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 137,003,138.8 (njëqind e tridhjetë e shtatë milion e tre mijë e njëqind e tridhjetë e tetë pikë tetë lekë) lekë pa TVSH.

Pikët totale të marra [100] jështë identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë:

Drejtoria e Përgjithshme e Tensionit të Lartë,

Adresa Rr. Gramoz Pashko, Vila Gri, Tiranë, Shqipëri,

Tel/Fax Nr. Tel. 00355692317299

**DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË  
DEGA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

---

E-mail [aleksander.pjetri@oshee.al](mailto:aleksander.pjetri@oshee.al) sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 58 të ligjit nr.9643, date 20.11.2007 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.10.2020

Ankesa: ka ose jo:

Po ka pasur dhe është dhënë vendimi në KPP datë 22.12.2020